

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË, Departamenti i përgjithshëm - Divizioni penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Gazmend Bahtiri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Mihrie Krasniqi-Sheholli, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.Z. nga P., rr. “...” pn, për shkak të veprës penale Vjedhje nga neni 252 par.1 të KPK-së, sipas Propozim Akuzës së PPK-së në Prishtinë, tani Prokuroria Themelore Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr.2694-8/2011 të dt. 03.10.2011, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor publik të mbajtur më dt.14.04.2016, në praninë e Prokurorit të Shtetit – Gjejrone Alaj, të akuzuarit dhe dëshmitarit B.G., të nesërmen me dt. 15.04.2016 mori dhe publikisht shpalli aktgjykimin, ndërsa me datë 26.04.2016 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari,

A.Z., nga i ati I. dhe nëna E., e vajzërisë D., i lindur më *data e lindjes...*, në P., ku edhe tani jeton në rr. “...” pn, nuk ka shkollë të kryer, bujk, i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar, baba i 9 (nëntë) fëmijëve, nga të dhënat penale të kësaj gjykate rezulton se i njëjti ka qenë i gjykuar edhe më parë, Shqiptar - Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

S e p s e :

Prej datës së pavërtetuar e deri me datën 14.03.2011, në lokalitë e tij i cili gjendet në P. rr. “...” pn, me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit t’i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, në njehsorin elektrik numër 62244467, ashtu që ka manipuluar me pllombat shtetërore, të hapura dhe prapë të mbyllura, numëruesi i njehsorit është i manipuluar, ka gjurmë të gërvishtjes së numrave në numëror, shifra e tretë nr. 1,2,3, shifra e katërt nr. 9,0,1,2 dhe shifra e pestë nr. 0,1,2 në T1, me ç’rast të dëmtuarës KEK-ut, Distribucioni në Prishtinë, i ka shkakuar dëm në vlerë prej 299.28 €,-

-Me këtë ka kryer veprën penale Vjedhje nga neni 252 par.1 të KPK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 3, 11, 34, 41, 42, 43, 44, 64 dhe nenit 252 par.1 të KPK-së, si dhe në bazë të nenit 365, 450, 453 dhe 463 të KPPRK-së, e

G J Y K O N

I. Të akuzuarin **A.(I.) Z.**, me dënim me kusht, ashtu që i shqipton dënim me gjobë në shumë prej 300€ (treqind/euro), të cilin dënim nuk do ta paguaj nëse i akuzuari në afat prej 1 (një) viti nuk kryen vepër të re penale.

II. Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve paushalle të paguajë shumën prej 50.00€ (pesëdhjetë euro), brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III. E dëmtuara KEK (tani KEDS) Divizioni i rrjetit në P., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontestin e rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

PPK në Prishtinë, tani Prokuroria Themelore Prishtinë-Departamenti i përgjithshëm, ka ushtruar propozim akuzën PP.nr.2694-8/2011 të dt. 03.10.2011, kundër të akuzuarit A.Z. nga P., rr. "...” pn, për shkak të veprës penale Vjedhje nga neni 252 par.1 të KPK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor më datë 14.04.2016, gjatë të cilës u dëgjuan prokurori i shtetit Gjerone Alaj nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, i akuzuari A.Z. dhe dëshmitari B.G.

Prokurori i shtetit në shqyrtim gjyqësor dhe fjalën përfundimtare deklaroi se aktakuza është e mbështetur në prova materiale, në foto-dokumentacion dhe deklarata të dëshmitarëve, andaj mbetem në tërësi pran aktakuzës dhe kërkoj nga gjykata që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit.

I akuzuari në shqyrtimin gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se nuk e pranoj fajësinë sepse nuk e kam kryer këtë vepër penale dhe kërkoj nga gjykata që të më shpall të pafajshëm për këtë vepër penale.

Gjykata gjatë procedurës së provave ka dëgjuar dëshmitarin B.G. – elektroteknik në qendrën e kalibrimit në P., po ashtu është dëgjuar i edhe akuzuari, si dhe ka lexuar: Vërtetimin për ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik me nr. 055935 të dt.22.12.2010, Procesverbalin e Qendrës së Kalibrimit me nr. 34/14 të dt.14.03.2011, Faturën me nr. DPR11HP09812 të dt.28.04.2011, si dhe është shikuar foto-dokumentacioni në shkresat e lëndës.

Në shqyrtimin gjyqësor publik në këtë çështje gjykata konform nenit 8 dhe nenit 361 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet dhe provat e lartcekura që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal e profesional dhe me ndërgjegje i ka vlerësuar çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë ka nxjerrë përfundim lidhur me faktet konkrete të vërtetuara.

Kjo gjykatë konsideron se përtej çdo dyshimi pas administrimit të provave në shqyrtimin gjyqësor vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Dëshmitari B.G. në shqyrtimin gjyqësor veç tjerash ka deklaruar se: tek ne në qendrën e kalibrimit sillen njehsorët e hequr nga tereni pa të dhëna tjera vetëm me shënimet që gjenden në tabelën me të dhëna teknike, e në njehsorin elektrik me numër 62244467 është konstatuar se nga pjesa e jashtme pllombat shtetërore janë të manipuluar – të hapura dhe prapë të mbyllura, ndërsa në brendi numëruesi i njehsorit është i manipuluar, ka pasur gjurmë të gërvishtjes së numrave në numëror, shifrat siç janë të cekura në procesverbal për të cilat posedojmë edhe dokumentacionin i cili gjendet në shkresat e lëndës.

Nga Vërtetimi mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik të lëshuar nga Divizioni i Shpërndarjes së KEK, me dt.22.12.2010, vërtetohet se është ndërruar njehsori i vjetër i prodhuesit Landis Gyr i tipit ML262f3 me numër 62244467 dhe është vendosur njehsori i ri i prodhuesit Iskra i tipit MTI73D1A44-L21M3KO me numër 47447246.

Nga Procesverbali mbi kontrollimin detal të njehsorit të energjisë elektrike, me numër 34/12 i punuar me dt.14.03.2011, të përpiluar nga Qendra e Kalibrimit të KEK-ut, vërtetohet se komisioni prej tre anëtarëve pas kontrollimit të njehsorit me numër 62244467 kanë konstatuar se nga ana e jashtme njehsori pllombat shtetërore i ka të manipuluar – të hapurta dhe prap të mbyllura, ndërsa nga pjesa e brendshme numëruesi i njehsorit është i manipuluar, ka gjurmë të gërvishtjes së numrave në numëror, shifra e tretë numrat 1,2,3, shifra e katërt numrat 9,0,1,2 dhe shifra e pestë numrat 0,1,2 në T1.

Nga Fatura DPR11HP09812 të dt.28.04.2011, shihen përlllogaritjet e rikthimit të humbjeve për energjinë elektrike të shpenzuar e të paregjistruar nga njehsori elektrik i konsumatorit – të pandehurit.

Nga foto-dokumentacioni në shkresat e lëndës shihet njehsori me numër, lloj dhe tip ashtu siç është regjistruar në emër të konsumatorit-të pandehurit A.Z., në të cilin shihet qartë manipulimi me pllomba, si dhe pluhuri gërvishtjet e mbetura në numra pas manipulimit të numëruesit.

Gjykata vërtetoi gjendjen faktike nga dëgjimi i dëshmitarit B.G., Vërtetimi mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik të lëshuar nga Divizioni i Shpërndarjes së KEK, me dt.22.12.2010, Procesverbali mbi kontrollimin detal të njehsorit të energjisë elektrike, me numër 34/12 i punuar me dt.14.03.2011 të përpiluar nga Qendra e kalibrimit të KEK-ut dhe foto-dokumentacioni në shkresat e lëndës, të cilave edhe jua fali besimin nga se ndërlidhen me njëra tjetrën.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Vjedhje nga neni 252 par.1 të KPK-së, për të cilën veprë penale gjykata edhe e shpalli fajtor dhe e dënoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Mbrojtjen e të akuzuarit, gjykata e ka vlerësuar duke e hedhur poshtë si të pa bazuar dhe në kundërshtim me provat e administruara dhe një përpjeke e të akuzuarit për t'iu shmangur përgjegjësisë penale.

Me rastin matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 64 të KPK-së, e në rastin konkret si rrethanë lehtësuese gjykata gjeti kushtet e rënda ekonomike dhe rrethanat familjare në të cilat jeton i akuzuari, ndërsa duke marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale si rrethanë rënduese gjykata gjeti se i njëjti ka qenë i gjykuar edhe më parë. Prandaj, gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është në përputhje me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të tij, ashtu që konsideroi se ky sanksion penal i cili iu shqiptua të akuzuarit është i drejtë dhe do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit, i paraparë me nenin 34 të KPK-së, në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, por ai duhet të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që t'i parandaloj nga kryerja e këtyre veprave penale.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marrë në kuptim të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, pasi që gjykata nuk pati ekspertizë nga ekspertë të pavarur lidhur me dëmin e shkaktuar nga i pandehuri, ndërsa faturën e KEK-ut lidhur me dëmin e shkaktuar e vlerësoi si të njëanshme.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale apo paushallit gjyqësor u morë në bazë të nenit 450 par.1 dhe par.2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË,
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni penal
P.nr.969/2011 e dt.26.04.2016

Sekretarja Juridike
Mihrije Krasniqi-Sheholli

Gjyqtari i vetëm gjykues
Gazmend Bahtiri

Këshilla Juridike: Kundër këtij Aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.